




REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIJA KUNDER KORRUPSIONIT	
AGJENCIJA PROTIV KORRUPCIJE	
ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep.	
Dep.	
Dep.	2-D/DPK
Nr. I faq.	
Broj stranica	02
Nr. pages	
Nr. Prot.	
Br. Prot.	01-2499/14
Prot No.	
Data	
Datum	04.07.2014
Date	
PRISHTINE	



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIJA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI – CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 (paragrafi 1.1), nenin 5 (paragrafi 1.5) dhe nenin 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korruptionit si dhe nenin 19 (paragrafi 11) të Rregullorës së Punës të Agjencisë kundër Korruptionit (nr.01/2014), Drejtori i Agjencisë kundër Korruptionit me datë 25.06.2014, nxjerr këtë:

V E N D I M

I, Mbylljet rasti me Nr. AKK-03-1699-14 për z. Ardian Rugova–Drejtor i Departamentit të Licencimit në Ministrinë e Shëndetësisë për shkak se, është shmangur situata e e konflikti të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt interesit në ushtrimin e funksionit publik, me nr. AKK-03-1699-14, për Zyrtarin e lartë, z.Ardian Rugova–Drejtor i Departamentit të Licencimit në Ministrinë e Shëndetësisë dhe njëkohësisht person i autorizuar në biznese private, është trajtuar sipas procedurës së paraparë ligjore, për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (Ligji Nr. 04/L-051).

Zyrtari i lartë, z.Ardian Rugova, fillimisht është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korruptionit, pas të cilës ai është kontaktuar nga zyrtaret e Agjencisë kundër Korruptionit, me ç'rast është njoftuar me situatën në të cilën ndodhet, si dhe me ndryshimet që duhet të bëjë, për të shmangur dhe për të parandaluar kështu situatën e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit të tij publik.

Zyrtari i lartë, z.Rugova, është deklaruar se do t'i bëjë këto ndryshimet e kërkuar për të parandaluar situatën e mundshme të konfliktit të interesit.

Ndërkohë, z.Rugova, në Agjencinë kundër Korruptionit, ka sjellur informacionet zyrtare nga Agjensioni për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (ARBK) "Informata mbi biznesin" (DPK-03-2286-14) në të cilën shihet se te biznesi privat, "Bleta" sh.p.k.. z.Rugova, ka hequr dorë krejtësisht nga pronësia dhe nga të qenurit person i autorizuar i biznesit privat, ndërsa te biznesi tjetër "Viv@net" d.p.sh. ka ruajtur të drejtën e pronësisë, por nuk ushtron funksion menaxhues në këtë ndërrmarrje, duke parandaluar kështu konfliktin e interesit me funksionin e tij publik – Drejtor i Departamentit të licencimit në Ministrinë e shëndetësisë.

II. Në mbështetje të nenin 18 (paragafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korruptionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrëthana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtore i DPK-së
- Z./zpj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./zpj. (zyrtari ndihmës)

Drejtore i Agjencise Kundër Korruptionit

